



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.118/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga Muhamet Rexha, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, përkitazi me ankesën e Ristiq Zoran kandidat për deputet nga rradhët e subjektit politik Jedinstvena Srpska Lista (JSL), paraqitur kundër QNR, në seancën e mbajtur më 02.02.2011, mori:

#### VENDIM

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Ristiq Zoran kandidat për deputet nga rradhët e subjektit politik Jedinstvena Srpska Lista (JSL).

#### ARSYETIMI

Me datën 31.01.2011 PZAP-i ka pranuar një ankesë në të cilën thekson se në bazë të dhënave të paraqitura nga ana e Qendrës për Numërim dhe Rezultate të datës 31.01.2011, në të cilën thotë se ka dyshime të arsyetuara për numrin e votave të regjistruara në mes të Z. Sreten Ivanović me numër rendor 4 në JSL (Jedinstvena Srpska Lista) dhe mua me numrin rendor 37, Z. Riziq Zoran.

Më tutje në ankesë theksohet se nga burimet e besueshme, nga anëtarët e KVV-ve nga të cilët kam qenë i informuar lidhur me rezultatet, kam konstatuar se jam i dëmtuar dhe ndoshta ka ardhur deri tek gabimi gjatë numërimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. PZAP ka pranuar nga pala ankuese edhe një material shtesë me datë 1 Shkurt 2011, duke bashkangjitur statistikën e rezultatit të zgjedhjeve për komunën e Noveberdes.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

3.6 (c) *Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, ne rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

**-ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstaton se ankesa është e pabazuar për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, për më tepër ankesa është e pabazuar për shkakun se në dëshmitë e ofruara në ankesë nuk specifikohet numri i votave të pretenduara si të dëmtuara, nuk ka bashkangjitur dëshmi që rrjedhin nga burimet e tij për të cilat pretendon se janë të besueshme të cilat do të dëshmonin për vjedhje të votave, si dhe nuk ka caktuar saktë se për cilin vendvotim apo qendër të votimit ka ndodhur shkelja e pretenduar.

Për këto arsye dhe bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 118/2011 më datën 02.02.2011.

**Kryesuesi i Panelit**

**Muhamet Rexha**

